

VENDIM
Nr. 441, datë 18.7.2018

**PËR NDRYSHIMIN E VARËSISË SË KLUBIT SPORTIV SHUMËSPORTËSH
“PARTIZANI” DHE KLUBIT SPORTIV “STUDENTI” NGA MINISTRIA E ARSIMIT,
SPORTIT DHE RINISË TE BASHKIA TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të ligjit nr. 79/2017, “Për sportin”, të nenit 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e varësisë së klubit sportiv shumësportësh “Partizani” dhe klubit sportiv “Studenti” nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë të Bashkia Tiranë.
 2. Buxheti i miratuar për vitin 2018 për klubin sportiv shumësportësh “Partizani” dhe klubin sportiv “Studenti”, bashkë me asetet në përdorim, transferohen nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë të Bashkia Tiranë. Transferimi i fondeve bëhet në formën e transfertës së kushtëzuar.
 3. Numri i punonjësve të klubit shumë-sportësh “Partizani” dhe klubit sportiv “Studenti”, në total 26 veta, transferohet te Bashkia Tiranë.
 4. Vendimi nr. 312, datë 15.5.2003, i Këshillit të Ministrave, “Për ndryshimin e varësisë së klubit sportiv shumësportësh “Partizani” nga Ministria e Mbrojtjes të Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve” dhe çdo akt nënligjor i miratuar për këto klube, shfuqizohen.
 5. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Bashkia Tiranë, klubi shumësportësh “Partizani” dhe klubi sportiv “Studenti” për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama